



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.449/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Aida Halimit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL.Anr.449/2017 e datës 23.10.2017 e Aida Halimit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 23.10.2017 nga Aida Halimi, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, me të cilën kërkon që të rinumërohen votat në Vendvotimet (VV), SH.M.U. “Selman Riza”- VV - 0901E/02R, 0901E/03R, 0901E/13R, në SH.M.U “Mihail Grameno” - VV 0901x/04D, 0901x/101D, f.sh. Sllatinë e Epërme VV - 0903E/01R, 0903E/02R, 0903E/03D, në fshatin Lismir ,VV 0915/01D, pasi që sipas parashtrueses së ankesës në këto vendvotime i mungojnë votat e familjarëve të saj.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesën përkitazi me mungesën e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi për shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hedh si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr. 449/2017 me datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Paneli
Zyhdi Haziri



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-